



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec
RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësitë Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 297 Nr. i faq./Br.str./No.pg 01

Data/Datum/Datë 30.03.2022

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë:30.03.2022 merr këtë:

V E N D I M

Për këmbimin e pronës komunale me pronën private

1. **Miratohet** propozimi Kryetarit të Komunës Nr. 02/1696/22, i datës: 09.03.2022 dhe jepet PËLQIMI për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur Podina, zonë kadastrale Rahovec, ngastra me numër P-71510057-01473-0, sipas Certifikatës së pronësisë, pronë e Komunës së Rahovecit, me sipërfaqe prej 69m² (gjashtëdhjetë e nëntë metra katror) e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 1123m² (njëmijë e njëqind e njëzet e tre metra katror) **I JEPET** në posedim Mehdi (Baki) Shehu nga Rahoveci, ndërsa ngastra sipas Certifikatës së pronësisë P-71510057-01472-3 në posedim të Mehdi (Baki) Shehu nga Rahoveci me sipërfaqe të përgjithshme prej 1360m² (njëmijë e treqind e gjashtëdhjetë metra katror) i mirret pjesa e parcelës me sipërfaqe prej 69m² (gjashtëdhjetë e nëntë metra katror) dhe **I JEPET** Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit për zgjerimin e rrugës publike në Rahovec.
2. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është për interes publik, përkatësisht për zgjerimin e rrugës publike në Rahovec dhe se në të njëjtin vend nuk ekzistojnë parcela tjera komunale të përshtatshme për këtë qëllim.
3. **OBLIGOHET**, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që t'i zhvilloj procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Vlerësimi i pronës komunale dhe pronës private të cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.

5. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar, me përbajtjen e të dhënave të pronave të këmbyera, si dhe emrin e pronarit privat me të cilin është bërë këmbimi.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.297/22
Me datë:30.03.2022

